



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:066448
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05231959

C.nr.1413/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.G., nga P..., përfaqësuar me autorizim nga B.O., avokat në P..., kundër të paditurës Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë, për pagat e papaguara, në shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur me datë 05.12.2023, ndërsa me datë 22.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E THEMELTË kërkesëpadia e paditësit A.G., nga Prishtina, dhe DETYROHET e paditura Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të pagave të papaguara për periudhën 15.07.2016 deri më 01.04.2021, t'ia paguajë pagën bruto shumën prej 17,812.50€, dhe në emër të kamatës shumën prej 6,188.06 euro, të gjitha në afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

II. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumë prej 1,048.80€, në afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të pagave të papaguara për periudhën 15.07.2016 deri më 01.04.2021, t'ia paguajë pagën bruto shumë prej 17,812.50€, dhe në emër të kamatës shumë prej 6,188.06 euro, të gjitha në afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata, seancën përgatitore dhe seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur në mungesë të së paditurës të ftuar në mënyrë të rregull, konform rregullave procedurale të përcaktuara me ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave, bëri administrimin e provave me leximin e: shkresa me titullin delegimi i inspektoreve- inspektori për shërbimet e navigacionit ajror për paditësen e datës 15.07.2016, kërkesa numër ... e datës 27.08.2020, vendimi numër A.nr. ... lëshuar nga KPMSHCK i datës 15.12.2020, vendimi numër A.nr. ... lëshuar nga KPMSHCK i datës 01.03.2021, vendimi numër Nr. Ref. ... i datës 26.03.2021, akt emërimi numër AE.nr. ... i datës 26.03.2021, rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshme të së paditurës, ekspertiza financiare e punuar nga ekspertja M.M. e datës 26.03.2023.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Me datën 01.09.2013, Paditësi e ka filluar marrëdhënien e punës pranë të Paditurës, në pozitën si Zyrtare e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për Meteorologji dhe Shërbime të Informatave Aeronautike.

Me datën 15.07.2016, në bazë të autorizimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i të Paditurës ia ka caktuar Paditësit detyrat dhe përgjegjësitë nga pozita e punës si Inspektor i Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Ky caktim është bërë në mënyrë formale përmes 'Inspection Delegation Letter'. Caktimi i detyrave dhe përgjegjësiive të reja sipas aktit të lartcekur, është bërë në pajtim me Rregulloren e miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës nr.08/2011, e datës 05.09.2011, për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit, miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me datën 17.01.2011.

Prej datës 15.07.2016, Paditësi në tërësi i ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara si Inspektore e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, duke konsideruar se e Paditura do të ndërmarrë ndryshimet adekuate në aktin e emërimit. Për fat të keq, E paditura në kundërshtim me dispozitat relevante ligjore, ka neglizhuar detyrimin juridik si punëdhënës për ndryshimin e aktit të emërimit.

Me datën 27.08.2020, Paditësi i është drejtuar me shkrim të Paditurit, për lëshimin e aktit të emërimit dhe kompensimin e diferencës në pagë, në përputhje me përgjegjësit dhe detyrat të cilat i janë caktuar Paditësit që nga data 15.07.2016

Pasi që i Padituri nuk i është përgjigjur fare kërkesës së lartcekur, Paditësi me datën 20.10.2020, ka parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. KPMCHC-ja me datën 15.12.2020, ka miratuar vendimin A.nr..., me të cilin e ka obliguar Drejtorinë e Përgjithshme të të paditurës, që të bëjë rishqyrtimin e kërkesës së Paditësit, të përshkruar në pikën 4 (katër) të kësaj padie.

Me datën 05.01.2021 I padituri e ka njoftuar KPMSHC-në, se e ka shqyrtuar kërkesën e Paditësit, duke mos e nxjerrë vendimin dhe duke vepruar sipas vendimit të lartcekur të KPMSHC-së. Paditësi i pa kënaqur me njoftimin e lartcekur të palës së Paditur, me datën 22.01.2021, ka parashtruar ankesën e lartcekur, me datën 01.03.2021, e nxori Vendimin A.nr..., me të cilin e ka obliguar të Paditurën që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, të ndryshoj aktin e emërimit të ankueses tani Paditësit, nga pozita e Zyrtares së Shërbimeve të Navigacionit Ajror në pozitën e Inspektorit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Me datën 26.03.2021, pala e paditur e miratoi vendimin me referencë ..., me të cilin Paditësit i është ndryshuar akti i emërimit nga Pozita së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në pozitën e Inspektore së Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Po të njëjtën datë, Paditësi e ka pranuar aktin e emërimit prej Burimeve Njerëzore të palës së Paditur, me referencë AE.nr..., me të cilin Paditësi emërohet në vendin e punës Inspektore e Shërbimit të Navigacionit Ajror.

Gjykata pasi që vërtetoi gjendjen faktike si më lartë ka vendosur ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar t'i paguhen pagat e

papaguara për periudhën gjatë të cilës paditësit nuk i është paguar paga, duke e detyruar të paditurën që t'ia njoh shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata vendosi që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, pasi që baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit është krijuar me vendimin e të paditurës nr. Ref... të datës 26.03.2021, ku me të cilin vendim paditëses i ndryshohet akt emërimi bazuar në vendimin A.nr... të datës 01.03.2021 të KPMSGK.

Sipas dispozitës së nenit 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë t'ia kompensoi, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, ndërsa në dispozitën e nenit 140 parashihet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”.

Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata ja ka falur në tërësi besimin ekspertizës financiare të datës 26.06.2023, të punuar nga eksperti financiar M.M. ngase e njëjta është punuar në mënyrë profesionale dhe është vlerësuar mjaftë bindëse për gjykatën, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit. Prandaj, nga të lartcekurat gjykata vendosi që paditësi të kompensohet në lartësinë e përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi si në dispozitiv, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 208.00€, sipas tarifës së OAK, taksa gjyqësore në shumë prej 100.00€, në emër të përpilimit të ekspertizës financiare shumë prej 200.00€ dhe për seancat e mbajtura shumë prej 540.80€.

Mbi bazën e të dhënave si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1413/2021, dt. 22.12.2023

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLË JURDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së tij, përmes kësaj gjykate për Gjykatën Apelit Prishtinë.